



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Nr. 5370 prot.

Kamëz, më 15.05.2026

V E N D I M

Nr. 458, datë 15.05 2026

“PËR

**NDËRMARRJEN E NISMËS PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTIT TË
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR, BASHKIA KAMËZ ME PROCEDURË TË
THJESHTUAR”.**

Mbështetur në nenin 8, pika 2; nenin 9, pika 1/1, shkronja “b” dhe nenin 23, pika 14 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenin 13, pika 1, shkronja “b” të Ligjit Nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar); nenin 12 të Vendimit Nr.686, datë 22.11.2017 “ Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit (i ndryshuar), Vendimit Nr.1, datë 27.07.2022 të Këshillit Kombëtar të Territorit “ Për Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kamëz, Vendimit Nr.61, datë 26.03.2022 të Këshillit Kombëtar të Territorit “ Për Miratimin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kamëz të miratuar me Vendim Nr.1, datë 27.07.2022 të Këshillit Kombëtar të Territorit, VKM Nr.427, datë 8.06.2016 “ Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Udhëzimit nr.1, datë 6.12.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit “ Për hartimin, bashkërendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të planeve të përgjithshme vendore me procedurë të thjeshtuar. Kryetari i Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Të ndërmarrë nismën për rishikimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me procedurë të thjeshtuar, për ato çështje dhe kërkesa të cilat:
 - a) Janë në përputhje dhe nuk bien në kundërshtim me legjislacionin sektorial në fushën e mjedisit, zonave të mbrojtura, trashëgimie historike e kulturore;
 - b) Janë në përputhje, nuk bien në kundërshtim dhe nuk ndryshojne dokumentin e Strategjisë Territoriale;
 - c) Vijnë si pasojë e konstatimit të gabimeve e mosperputhjeve në dokumentin e Planit dhe mes pjesëve përbërëse të tij, si edhe mes Planit e gjendjes faktike në territor;
 - d) Vijnë si pasojë e forcave madhore, si: tërmete, përmbytje, zjarre masive, rrëshqitje të tokës, erozion, etj., të ngjashme, për shkak të ndarjeve administrative e territoriale,

ndryshimeve te paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshimeve të shkaktuara nga kriza sektoriale;

- e) Vijnë si nevojë për harmonizimin me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafritimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është dokumenti i nismës.
 3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Kamëz.
 4. Vendimi për miratimin e Nismës dhe dokumenti i Nismës botohen në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e miratimit.

